



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA

04-05-2015

Titulli / Titulli i Propozimit	01-013/636		
Ind. origjinal	Kumtari/Emri	Shprehja	Titulli
Org. broj			



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Bazuar në nenin 12.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta zyrtare nr 2008/28 dhe nenit 36 shkronja d) të Statutit të Komunës së Vitisë nr 01-013/491 të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në seancën e mbajtur më 29.04.2015 aprovon këtë:

V E N D I M

PËR SHPALLJEN E DISKUTIMIT PUBLIK PËR PROPOZIM RREGULLOREN
PËR MËNYRAT, PROCEDURAT DHE KUSHTET E PJESËMARRJES SË
QYTETARËVE NË PROCESET E VENDIMMARRJES

I.

Kuvendi i Komunës së Vitisë SHPALL diskutim publik për propozim Rregulloren për mënyrat, procedurat dhe kushtet e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset e vendimmarrjes.

II.

Propozim Rregullorja për mënyrat, procedurat dhe kushtet e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset e vendimmarrjes do të jepet në diskutim publik deri më 15 Maj 2015.

III.

Debati me publikun do të mbahet më 15 Maj 2015 në ora 10,⁰⁰ në sallën e Kuvendit të Komunës së Vitisë,

IV.

Të drejtë pjesëmarrje në diskutim publik kanë të gjithë qytetarët e interesuar, organet dhe institucionet e Komunës së Vitisë.

V.

Qëllimi i këtij diskutimi publik është për të krijuar opinione pozitive për propozimet e bëra për propozim Rregulloren për mënyrat, procedurat dhe kushtet e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset e vendimmarrjes.

VI.

Materiali lidhur me propozim Rregulloren për mënyrat, procedurat dhe kushtet e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset e vendimmarrjes mund të merret në Shërbimin e Kuvendit, Zyrën Ligjore dhe i njëjti do të jetë i shpallur në tabelën e shpalljeve dhe në Veb faqen e Komunës së Vitisë në internet.

VII.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

KRYESUESI I KUVENDIT

Naim Pira

